



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
**Komuna e Vushtrrisë**  
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtri



Bazuar në nenin 13 të Udhëzimit Administrativ Nr 03/2020 për Transparencë në Komuna, dhe nenin 5 par. 1, nenin 7 par. 1 pika 1.2 të Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, me datën 25.11.2022 ipet ky:

### **NJOFTIM PËR KONSULTIM PUBLIK**

Komisioni komunal e publikon për konsultim publik Draft - Rregulloren për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë.

Konsultimi publik do të zgjasë nga data 25 nëntor 2022 deri më 26 dhjetor 2022.

Ju bëhet ftesë qytetarëve, OJQ-ve, shoqërisë civile dhe të gjithë të interesuarve tjerë, që gjatë kësaj periudhe kohore të i paraqesin sugjerimet, propozimet apo komentet në Draft-Rregulloren e sipërsëhënuar, në adresën elektronike: [islam.latifi@rks-gov.net](mailto:islam.latifi@rks-gov.net).

Ju njoftojmë gjithashtu se me datën **20 dhjetor 2022 (e martë)** do të mbahet takim publik me qytetarë lidhur me Draft rregulloren në fjalë në të cilën mund të paraqiten propozime për ndryshim apo plotësim.

Takimi publik do të mbahet në sallën e kuvendit të komunës me fillim në ora 11:00.

Në shtojcë mund të gjeni të bashkangjitur Draft - Rregulloren për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë.

Mirëpresim pjesëmarrjen në këtë takim publik.

Komisioni:

- 1.
- 2.
- 3.